



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT-VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_ 2020

“PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9975,  
DATË 28.7.2008 ‘PËR TAKSAT KOMBËTARE’, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neneve 81, pika 1 dhe nenit 100 të Kushtetutës, me propozim të Ministrit të  
Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat  
kombëtare”, të ndryshuar” për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë,  
sipas tekstit dhe relacionit shoqërues që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. \_\_\_\_\_ /2020

“PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008 ‘PËR TAKSAT  
KOMBËTARE’, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neneve: 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar bëhet ndryshimi si më poshtë vijon;

Neni 1

Në nenin 4, “Niveli i taksave kombëtare” bëhet ndryshimi me këtë përmbajtje:

“Në pikën 4, në paragrafin e parë dhe të tretë, fjalët “*në masën sa 3/7 e normës së rentës për vitin 2019, 3/8 e normës së rentës për vitin 2020 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2021 e në vijim*”, zëvendësohen me fjalët “*në masën 0% për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij ligji deri për një periudhë 3 vjecare dhe 1/3 e normës së rentës për periudhën në vijim*”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit ne fletoren zyrtare.

KRYETAR

GRAMOZ RUCI

RELACION  
PËR  
PROJEKTLIGJIN

“PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008 ‘PËR TAKSAT  
KOMBËTARE’, TË NDRYSHUAR”

**I. QELLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QE SYNOHEN TE ARRIHEN**

Propozimi i projektligjit "Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, date 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar", është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

- Ky projektligj ka për qëllim të mbështesë industrinë e perpunimit të mineraleve metalore e cila po përjeton një periudhë krize të thellë si pasojë e efekteve të pandemisë COVID-19, efekte që kanë shkaktuar dhe ulje të kërkesës dhe cmimeve të tregut ndërkombëtar të nënprodukteve minerare metalore.

- Ndryshimi i propozuar synon gjithashtu që të incentivojë përpunimin në vend, rritjen e investimeve, punësimin si dhe një shfrytëzim më të balancuar dhe të qëndrueshëm të mineraleve që janë pasuri kombëtare.

- Projektligji parashikon përjashtimin (taksë zero) nga taksa e rentës minerare për një periudhë 3-vjecare që fillon nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji për mineralet metalore që përpunohen në vend dhe eksportohen në formën e nënprodukteve minerare (ferrokromi, koncentratet e kromit dhe të bakrit).

**II. VLERESIMI I PROJEKTAKTIT NE RAPORT ME PROGRAMIN POLITIKTE KESHILLIT TE MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TE AKTEVE DHE DOKUMENTE TE TJERA POLITIKE**

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Keshillin e Ministrave gjatë vitit 2020 dhe vjen si kërkesë e industrisë minerare në një kohë kur industria minerare po përjeton një periudhë krize të thellë si pasojë e uljes së kërkesës dhe cmimeve të tregut ndërkombëtar .

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Industria minerare përfaqëson ndër vite një nga sektoret me kontribut të qënësishëm në terma të rritjes ekonomike dhe të punësimit në vend. Produktet e industrisë minerare përbëjnë gjithashtu një ndër kategoritë kryesore të eksporteve vendase, e cila ndër vite ka kontribuar pozitivisht në përmirësimin e bilancit tregtar vendas.

Ndër drejtimet specifike të strategjise minerare (Strategjia Minerare e Republikës së Shqipërisë 2010 - 2025") në vecanti për industrinë e kromit që perfaqeson dhe mineralin me kontribut më të madh në sektor, citojmë:

*"kromi duhet të shkojë drejt përpunimit, duke ulur në minimum eksportin si mineral dhe rritur eksportin si ferrokrom, zgjerimi i rezervave për kromet e varfra e trajtimi i tyre për prodhim koncentratesh kromi. Vendburimet kryesore të Bulqizës dhe Batrës kërkojnë doemos një koordinim të bizneseve të vogla që sasia e përgjithshme e mineralit të këtyre vendburimeve të shkojë në përpunim të plotë."*

*"zhvillimi i një sistemi të strukturuar integruar të prodhimit të kromit, që përfshin veprimtari minerare, pasurimi dhe shkrirjeje, kjo e parë në menyre të vecantë për dy vendburimet kryesore të kromit Bater e Bulqize. Në këtë kontekst, nuk duhet lënë i vecuar masivi Kukës-Tropoje ku veprimtaritë minerare në vitet e fundit janë intensifikuar dhe këtu merr rëndësi trajtimi i kromiteve të varfra"*

Në zbatim të këtyre drejtimeve strategjike, me qëllim zhvillimin e industrisë përpunuese dhe racionalizimin e shfrytëzimit të burimeve natyrore me qëllim frenimin e eksportimit të mineralit bruto të papërpunuar me vlerë të ulët, janë ndërmarrë dhe më parë nisura për reduktimin e nivelit të taksës së rentes minerare për mineralet metalore që përpunohen në vend. Kjo, ka patur një efekt pozitiv pasi u investua në kapacitete përpunuese duke dyfishuar prodhimin e nënprodukteve minerare, por nga ana tjetër pati një efekt të kufizuar në frenimin e eksporteve të mineralit të pa përpunuar (bruto) në vend.

Eksportimi i mineralit të kromit të përpunuar paraqet vlerë rreth tre herë më të lartë sesa në rastin kur minerali është i përpunuar. Kjo përkthehet në fitim më të madh për vendin në terma të prodhimit të brendshëm bruto, eksporteve dhe vendeve të punës. Procesi i përpunimit, si një proces që i shton vlerë mineralit bazë kontribuon ndjeshëm në ngushtimin e deficitit tregtar vendas dhe do të kontribuonte në zhvillimin ekonomik lokal pasi dhe zonat në të cilat operon ky sektor janë dhe zonat me zhvillim ekonomik më të ulët.

Nga ana tjetër, të pakten industria e kromit në Shqipëri po përballet me pakësimin e përshpejtuar të rezervave të kromit, tregtimit të tij në trajtën e mineralit me vlerë të shtuar të ulët. Niveli aktual i shfrytëzimit dhe nxjerrjes së mineralit pengon realizimin e investimeve në sektorin e përpunimit dhe vë në dyshim mundësinë e rikuperimit të investimeve të kryera deri më tani dhe atyre të reja për të ardhmen.

Aktualisht, përdorimi i instrumenteve të politikës fiskale, që të stimulojë eksportin e produkteve të përpunuara dhe të frenojë/racionalizojë tregtimin e mineralit bruto,

sot është akoma më emergjent pasi si pasojë e pandemisë COVID-19, situata botërore e tregut në lidhje me kërkesën dhe cmimet e mineraleve dhe

nënprodukteve të tyre është në periudhën më të vështirë të këtyre dekadave të fundit.

Shumë miniera, uzina dhe fabrika, sidomos ato metalore kanë ulur kapacitetin dhe rrezikojnë dhe mbylljen totale duke rrezikuar mijëra vende pune. Efektet e kësaj krize parashikohen të jenë afatgjate dhe ulja e kostove është e vetmja mënyrë për të mbijetuar në treg, për të mos falimentuar dhe mbajtur punësimin aktual.

Në grupin e mineraleve metalore që preken nga ky projektligj përfshihen kromi dhe bakri. Ky është grupi më i rëndësishëm i mineraleve që përfaqëson rreth 85% të investimeve që realizohen çdo vit në industrinë minerale. Brenda këtij grupi, minerali kromit ka peshën më të madhe me rreth 80% të investimeve.

Në këtë kuadër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqata e Minerave të Shqipërisë, Shoqata Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë propozuan që të ndërmerret nisma për heqjen e rentës minerare për grupin e mineraleve metalore që përpunohen në vend për të paktën një periudhë 3 vjecare. Ky përjashtim do të ketë efekte në mineralet metalore që përpunohen në vend si kromi dhe bakri që janë dhe mineralet kryesore që prodhohen në vend. Ndërkohë, të njëjtat minerale që eksportohen të papërpunuara do të vijojnë të kenë të njëjtin nivel të rentës minerare.

#### IV. VLERESIMI I LIGJSHMERISE, KUSHTETUTSHMERISE DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NE FUQI, VENDAS E NDERKOMBETAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe 155 të Kushtetutit të Republikës së Shqipërisë,

#### V. VLERESIMI I SHKALLES SE PERAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PER PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

#### VI. PERMBLEDHJE SHPJEGUESE E PERMBAJTJES SE PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 2 nene:

Në nenin 4, "Niveli i taksave kombëtare", bëhen ndryshimet si vijon:

Në pikën 4, në paragrafin e parë dhe të tretë, fjalët "në masën sa 3/7 e normës së rentës për vitin 2019, 3/8 e normës së rentës për vitin 2020 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2021 e në vijim" zëvendësohen me fjalët "në masën 0% për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij ligji deri për një periudhë 3 vjecare dhe 1/3 e normës së rentës për periudhën në vijim".

Në Nenin 2, parashikohet që ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QE NGARKOHEN PER ZBATIMIN E KETIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin e këtij akti ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Administrata Doganore.

## VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QE KANE KONTRIBUAR NE HARTIMINE PROJEKTAKTIT

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka draftuar projektligjin në kuadër të propozimeve të ardhura nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqatës së Minierave të Shqipërisë dhe Shoqatës së Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë. Ky projektligj i dërgohet për mendim Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, dhe Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

## IX. RAPORTI I VLERESIMIT TE TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji parashikohet që për periudhën 3-vjecare të sjellë një efekt negativ prej afërsisht 500 milionë lekë në buxhetin e shtetit. Kjo vlerë llogaritet si vijon;

Në periudhat e kaluara, pagesa e rentës minerare për koncentratin/ferrokromin e eksportuar ka qënë:

Në vitin 2018	80	milion lekë
Në vitin 2019	37,5	milion lekë
Në 4 mujorin 2020	10,5	milion lekë.

Për koncentratin e bakrit, pagesa vjeotre e rentës varion 100 milion lekë në situatë normale dhe 200 milion lekë kur ka rritje të kërkesës.

Efekti i pritshëm 3 vjecar nga heqja e rentës për mineralet metalore që përpunohen do jetë:

- Nga renta e mineralit të përpunuar të kromit, -180 milion lekë në 3 vjet (60 milion lekë në vit mesatarja e viteve 2018-2019)
- Nga renta e mineralit të përpunuar të bakrit që eksportohet, - 300 milion lekë në 3 vjet (rreth 100 milion lekë në vit)
- Pra, efekti total 3-vjecar llogaritet rreth -500 milion lekë.

ANILA DENAJ

---

MINISTËR